



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr. 35 datë 22.02.2019

**PËR NDËRPRERJEN E URDHËRIT PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM**

Në Tiranë, sot më datë 22.02.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi dëgjoj në seancën plenare të datës 22.02.2019, relacionin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, si dhe mendimet e paraqitura nga anëtarët e Këshillit në mbledhje

**KONSTATOJ**

Me urdhërin nr.103 datë 04.04.2018, Prokurori i Përgjithshëm, bazuar në nenin 160/4 të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, ka caktuar përkohësisht prokurorin z. Ardian Nezha, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, të ushtrojë këtë funksion si prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Drejtuesia e Prokurorisë Pukë, me shkresat me nr.54, prot., datë 10.01.2019, ka informuar Këshillin e Lartë të Prokurorisë për ngarkesën në punë në prokurorinë e Pukës. Më konkretisht Drejtuesia e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, ka informuar Këshillin se:

*“Në organikën e Prokurorisë Pukë janë parashikuar të jenë 3 prokurorë, përfshirë drejtuesin e Prokurorisë. Pavarësisht këtij numri prokurorësh, nje prokuror është transferuar, ndërsa një prokuror është caktuar përkohësisht në një prokurori tjetër, që më datën 31.01.2018. Që nga kjo datë janë komanduar prokurorë të ndryshëm, nga Prokurori të tjera në periudha të caktuara, për të përballuar volumin e punës në Prokurorinë e Rethit Gjyqësor Pukë. Por që nga data 07.12.2018, është duke e ushtruar detyrën në këtë Prokurori, vetem ajo si drejtuese prokurorie.*

*Në këtë prokurori janë nën hetim disa procedime penale, me persona nën hetim dhe me të arrestuar, ku për shkak të lidhjeve farefisnore, drejtuesja e prokurorisë, prokurorja Elidiana Kasa, nuk mund të ushtrojë funksionin e prokurorit, për shkak të papajtueshmërisë procedurale.*

*Në këto rrethana drejtuesja e prokurorisë, ka kërkuar plotësimin e organikës, për të bërë të mundur ushtrimin e ndjekies penale në kushtet e respektimit të afateve procedurale.*

Sipas nenit 160/4 të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, Prokurori i Përgjithshëm, në kushtet kur nuk ishte krijuar akoma Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë mund të vendoste, caktimin në pozicione të përkohshme të magjistratëve. Kjo dispozitë ishte kalimtare dhe si e tillë nuk parashikonte afate dhe rregulla.

Prokurorja e Përgjithshme bazuar në kopetencën e saj ligjore ka caktuar me urdhërin nr.14 datë, 09.01.2018, Prokurorin z.Ardian Nezha, të kryejë detyrën përkohësisht në Prokurorinë pranë

Gjykatës së shkallës së parë Elbasan, dhe me urdhërin nr.103 datë 04.04.2018, ky prokuror është caktuar përkohësisht, të kryejë detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, tashmë i krijuar, ka për detyrë ndër të tjera të garantojë funksionimin e prokurorive, pavarësinë, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet kushtetuese si edhe në përputhje me rregullimet ligjore të parashikuara në pjesën e tretë të Ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të titulluar “Zhvillimi i karrierës së magistratëve”.

Në kushtet e krijuara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, çmohet e domosdoshme ndërprerja e urdhërit nr.103 datë 04.04.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për caktimin në pozicion të përkohshëm”, të z.Ardian Nezha, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe rikthimi i tij në pozicionin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 “ Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë“ Këshilli i Lartë i Prokurorisë

### VENDOSI

1. Të ndërpresë efektet e Urdhërit nr.103 datë 04.04.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Ardian Nezha, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe ta rikthejë në pozicionin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë.
2. Të njoftohen me këtë vendim prokurori Ardian Nezha, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETARI  
GENT I BRAHIMI**

**ZV/KRYETARI  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
ANTONETA SEVDARI**

**ANËTAR  
ARBEN DOLLAPAJ**

**ANËTAR  
BESNIK ÇANI  
(kunder)**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI  
(kunder)**

**ANËTAR  
GENTJAN OSMANI**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI  
(kunder)**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ  
(kunder)**